

“Kosovë, ne të dalim zot”, publikohet logoja zyrtare për 16-vjetorin e pavarësisë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI, I ËSHTË DREJTUAR TË DIELËN ME NJË MESAZH KOMUNITETIT SERB NË KOSOVË LIDHUR ME RREGULLOREN E RE TË BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS (BQK)

## KURTI: NGA 1 SHKURTI DINARI NUK MUND TA KALOJË KUFIRIN ME THASË, POR VETËM PËRMES LLOGARIVE BANKARE



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) nuk ia ndalon Serbisë t'u ndihmojë serbëve të Kosovës, as nuk e ka ndaluar

dinarin sikurse asnjë valutë tjetër. Kurti duke iu referuar rregullores së BQK-së, e cila ka hyrë në fuqi më 1 shkurt, ka theksuar se kjo rregullore parashih që valuta e vetme

për kryerje të transaksioneve me para të gatshme është euroja. Për Kurtin çdo interpretim tjetër i rregullores përbën fushatë mbi baza të rreme

### AKTUALE



PERËNDIMI KRITIKON TRUMPIN PËR KOMENTET RRETH NATO-S | F. 2

KRYEMINISTRI FRANCEZ: MOSHA MINIMALE PËR PËRDORIM TË RRJETEVE SOCIALE TË JETË 13 VJEÇ | F. 6

SISTEMI I DREJTËSISË SË HAGËS | F. 7



Shkruan:  
Sali BISLIMI

### EKONOMI



FATURAT E MISTERSHME: KUSH PO E PAGUAN RRYMËN NË VERI? | F. 8

### SPORT



LLAPI MPOSHTI NË DERBI DRITËN, FITOJNË BALLKANI DHE PRISHTINA | F. 10

UNIVERSITETI I PRISHTINËS ME LIBRA TË VJETËR DHE PA QASJE NË REVISTA SHKENCORE | F. 7



GRAFITE TË REJA NË VERI ME NËNSHKRIM TË BRIGADËS SË VERIUT | F. 6



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Perëndimi kritikon Trumpin për komentet rreth NATO-s

**BRUKSEL, 11 SHKURT** - Zyrtarë të lartë të Perëndimit e kanë kritikuar ish-presidentin amerikan Donald Trump të dielën, pasi ai ka sugjeruar se Shtetet e Bashkuara mund të mos i mbrojnë aleatët e NATO-s - që nuk janë duke ndarë mjaftueshëm para në mbrojtje - nga një pushtim potencial prej Rusisë. “Çdo sugjerim që aleatët nuk do ta mbrojnë njëri-tjetrin, dëmton sigurinë e të gjithëve, përfshirë atë të ShBA-së, dhe i rrezikon ushtarët amerikanë dhe ata evropianë”, ka thënë sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, përmes një deklarate me shkrim. “Çdo sulm ndaj NATO-s do të rezultojë me një përgjigje të përbashkët dhe të fuqishme”, ka thënë ai.

Trumpi ka gjasa ta fitojë nominimin e republikanëve në garën presidenciale, që do të mbahet në nëntor të këtij viti. Ministri polak i Mbrojtjes, Wladyslaw Kosiniak-Kamysz,

ka reaguar, po ashtu. “Motoja e NATO-s është ‘një për të gjithë, të gjithë për një’, dhe ky është përkushtim konkret. Minimi i kredibilitetit të shteteve aleate nënkupton dobësim të gjithë NATO-s”, ka thënë ai në “X”, platformë e njohur më parë si “Twitter”. “Asnjë lloj i fushatës nuk është arsye për të luajtur me sigurinë e aleancës”. Ministria e Jashtme e Gjermanisë ka postuar një mesazh në “X”: “Një për të gjithë, të gjithë për një”, me thirrjet “Së bashku më të fortë”, pas komenteve të Trumpit. Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, ka thënë se “deklaratat për sigurinë e NATO-s dhe Aktin 5 u shërbejnë vetëm interesave të [presidentit rus, Vladimir] Putin”.

Artikulli 5 i traktatit të NATO-s përcakton se një sulm i armatosur kundër një anëtari të aleancës konsiderohet sulm kundër të gjitha vendeve dhe nxit mbrojtje të përbashkët. Trumpi, duke e rikujtuar një



takim me liderë të NATO-s, gjatë një marshi politik në Karolinën e Jugut, e ka cituar presidentin e një “shteti të madh”, që nuk ia ka përmendur emrin, duke e pyetur atë: “Zotëri, nëse ne nuk paguajmë dhe sulmohemi nga Rusia, a do të na

mbroni?” “I kam thënë: ‘Nuk keni paguar? Jeni delikuent?’ Ai ka thënë: ‘Po, kështu ka ndodhur’. Jo, nuk do t’ju mbroj juve. Në fakt do t’i inkurajoja ata të bëjnë çfarë të duan. Duhet të paguani”. “Ne e kemi dëgjuar këtë më parë... asgjë e re”, ka thënë komisionari i

Bashkimit Evropian për Treg të Brendshëm, Thierry Breton, në një intervistë për televizionin francez LCI. “Ai ndoshta ka probleme me kujtesën mirëpo, në fakt, ka qenë një presidente, jo një shtet, por Bashkimi Evropian”, ka thënë Breton, duke iu referuar një bisede që ka pasur presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, me Trumpin më 2020.

Zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, Andrew Bates, i pyetur për komentet e Trumpit, ka thënë se “inkurajimi i pushtimit të aleatëve tanë të ngushtë nga regjimet vrasëse, është i tmerrshëm dhe i pavarur - e rrezikon sigurinë kombëtare amerikane, stabilitetin global dhe ekonominë në shtëpinë tonë”.

Te 31 vendet anëtare të NATO-s janë pajtuar që të ndajnë të paktën 2 për qind të Bruto Prodhimit të Brendshëm në fushën e mbrojtjes, mirëpo të dhënat e NATO-s kanë treguar se vetëm 11 prej tyre janë duke vepruar ashtu.

## Kievi pretendon se ushtria ruse po e përdor Starlinkun në zonat e pushtuara

**KIEV, 11 SHKURT** - Zyrtarët ukrainas të mbrojtjes kanë pretenduar se forcat ushtarake ruse në zonat e pushtuara në lindje të Ukrainës janë duke përdorur terminale të shërbimit të internetit të ofruar prej Starlinkut në pronësi të miliarderit amerikan Elon Musk.

Dega e Inteligjencës në Ministrinë ukrainase të Mbrojtjes e ka postuar më 11 shkurt në Telegram një audioincizim të momentit kur, sipas saj, është identifikuar komunikimi mes dy ushtarëve rusë, duke pretenduar se kjo është dëshmi e përdorimit të vazhdueshëm të sistemit. SpaceX, e cila i zotëron terminale e Starlinkut, ka thënë



përmes një deklarate më 8 shkurt në “X” - platformë e njohur më parë si “Twitter” - se “nuk bën biznese të çfarëdo lloji me qeverinë ruse apo ushtinë e

saj” dhe se shërbimet e saj nuk funksionojnë në Rusi. Zyrtarët ukrainas kanë thënë se në incizim zyrtarët rusë janë dëgjuar duke diskutuar për

vendosjen e terminaleve në lindje të Ukrainës.

Nuk janë dhënë më shumë hollësi për shkallën e përdorimit, apo se si janë siguruar terminalet.

Zëdhënësi Andriy Yusov u ka thënë medieve ukrainase më 10 shkurt se kjo çështje i takon një “natyre sistematike”.

Starlinku është një rrjet me mbi 2 000 satelitë në orbitën e Tokës, bashkë me mijëra terminale në terrenet e planetit. Ai është aktivizuar mbi Ukrainë në fund të shkurtit të vitit 2022, pasi shërbimet e internetit janë dëmtuar nga lufta e nisur prej Rusisë.

Prania e Starlinkut në Ukrainë jo vetëm që ka qenë e vlefshme për operacionet luftarake, por ajo ka

ndihmuar në rregullimin e infrastrukturës së energjisë dhe komunikimeve që janë shënjestruar nga Rusia. Megjithatë, secilën herë e më shumë ka dilema për përkushtimin e Muskut për t’i mbështetur përpjekjet e Ukrainës në luftë.

Musku ka thënë se e ka parandaluar një sulm ukrainas në një bazë ruse më 2022, duke e refuzuar një kërkesë të Kievit për të aktivizuar shërbime të internetit në Detin e Zi, afër Krimesë ukrainase të aneksuar prej Moskës.

Deklaratat e Muskut në shtator të vitit 2023 janë kritikuar ashpër prej Mykhaylo Podolyakut, ndihmësit të presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky.

## Kryeministri francez: Moshë minimale për përdorim të rrjeteve sociale të jetë 13 vjeç

**PARIS, 11 SHKURT** - Kryeministri francez Gabriel Attal dëshiron t’ua pamundësojë fëmijëve nën moshën 13-vjeçare t’i përdorin rrjetet sociale, sipas një interviste që ka dhënë për gazetën “Le Parisien”. “Dua të punoj me platformat për një barrierë të vërtetë digjitale, për t’u siguruar që asnjë i mitur nën moshën 13-

vjeçare të ketë qasje në rrjetet sociale”, ka thënë Attal. Sipas tij, të rinjtë e moshave 13-15-vjeçare do të duhej t’i përdornin rrjetet sociale vetëm me leje të prindërve. Adolehentëve në Francë u mundësohet që ligjërisht të krijojnë llogari në rrjetet sociale prej moshës 15-vjeçare. Para asaj moshe ata duhet ta

kenë miratimin e prindit. Attal është shprehur i bindur që mund jetë i suksesshëm në këtë drejtim. “Kjo është diçka shumë e vështirë, por jo e pamundshme”, ka thënë ai, duke përmendur rëndësinë e bashkëpunimit me platformat si “Facebook” dhe “Tiktok”, meqë ato, sipas tij, janë të vetëdijshme se po rrezikohet imazhi i tyre.



## Grafite të reja në veri me nënshkrim të Brigadës së Veriut

PRISHTINË, 11 SHKURT - Në katër komunat veriore të Kosovës, me shumicë serbe, janë parë të dielën disa grafite të reja me mesazhet "Kur të kthehet ushtria në Kosovë, Brigada e Veriut jeton".

Zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se prokuroria ka iniciuar rast për shkak të "përhapjes së urrejtjes". Sipas tij, ende nuk dihet kush i ka krijuar grafitet.

Qeveria e Kosovës i ka shpallur Brigadën Veriore dhe Mbrojtjen Civile si organizata terroriste në fund të qershorit të vitit 2023.

Besohet se këto dy organizata veprojnë në veri të Kosovës dhe numërojnë qindra anëtarë nga radhët e komunitetit serb.

Kjo nuk është hera e parë që Brigada e Veriut ka bërë grafite të tilla në veri të Kosovës.

Në disa prej tyre ishte thënë: "Mos u shqetësoni, ne jemi këtu, po presim".

Po ashtu, dhjetë ditë para sulmit ndaj Policisë së Kosovës nga një grup i armatosur serb në Banjskë të Zveçanit, vitin e kaluar, në Mitrovicë të Veriut është parë grafiti "Kur ushtria të kthehet në Kosovë".

Në grafitet e reja në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe



Zubin Potok, përmendet se autore është Brigada e Veriut.

Grafite me mbishkrime identike janë shfaqur në qytetet e Serbisë qysh prej mesit të vitit të kaluar, dhe ato janë bërë prej tifozëve të klubit të futbollit Crvena Zvezda.

Grafitet e reja janë parë në veri të Kosovës në kohën kur serbët janë

duke shfaqur pakënaqësi lidhur me vendimin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për ta bërë euron si valutën e vetme për kryerje të pagesave dhe duke e pamundësuar kështu përdorimin e dinarit serb për transaksione.

Serbia ndan fonde për serbët në Kosovë dhe ua paguan rrogat,

pensionet dhe ndihmat sociale në dinarë serbë.

Ditët e fundit autoritetet e Kosovës i kanë mbyllur edhe shtatë institucione paralele serbe të cilat Kosova i konsideron ilegale me Kushtetutë.

Komuniteti ndërkombëtar i ka bërë thirrje Kosovës të mos marrë

vendime që ndikojnë negativisht te komuniteti serb në Kosovë dhe t'i shmangë tensionet.

Perëndimi ka kërkuar që Kosova dhe Serbia t'i zgjidhin të gjitha çështjet e hapura në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian që prej vitit 2011.

## Rama: Blinkeni do të gjejë në Tiranë një vend të angazhuar për paqe të rajonit



TIRANË, 11 SHKURT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, do ta gjejë Shqipërinë të angazhuar për paqen dhe stabilitetin e rajonit, kur të zhvillojë një vizitë në këtë vend javën e ardhshme.

Departamenti amerikan i Shtetit ka konfirmuar se Blinkeni do të udhëtojë në Shqipëri dhe Gjermani në periudhën 14-17 shkurt.

Kjo vizitë ka për synim t'i riafirmojë lidhjet e Uashingtonit me Tiranën.

Rama e ka vlerësuar lart vizitën e kryediplomatit amerikan në vendin e tij, në një periudhë, sipas tij, të trazuar për botën. Ai e ka rikonfirmuar mbështetjen e Shqipërisë ndaj përpjekjeve të ShBA-së dhe Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Këto të fundit dialogojnë në

Bruksel, me ndërmjetësim të bllokut evropian, prej vitit 2011, me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve. Ai e ka përmendur, mes të tjerash, edhe reformën në drejtësi në Shqipëri, duke thënë se vendi i tij është falënderues për "partneritetin e çmuar të Shteteve të Bashkuara në reformimin historik të sistemit të drejtësisë".

Në dhjetor të vitit 2019 në Shqipëri është krijuar Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), me qëllim të hetimit të korrupsionit në nivelet e larta dhe krimin e organizuar.

Shtetet e Bashkuara kanë thënë se e mbështesin punën e SPAK-ut.

Së fundi është krijuar edhe një ministri e re, ajo për Administratë dhe Anti-Korrupsion, e cila është përgjegjëse për aktivitetet kundër korrupsionit.

Në krye të saj është emëruar Adea Pirdeni, e cila deri më tani ka qenë zëvendësministre e Drejtësisë.

## "Kosovë, ne të dalim zot", publikohet logoja zyrtare për 16-vjetorin e pavarësisë

Prishtinë, 11 shkurt - Qeveria e Kosovës ka publikuar logon zyrtare për shënimin e 16-vjetorit të pavarësisë. "Kosovë, ne të dalim zot", është mbishkrimi që është vendosur në logon zyrtare shtetërore.

"Logoja zyrtare shtetërore për shënimin e 16-të vjetorit të Pavarësisë dhe programi i plotë i manifestimeve shtetërore për shënimin e 16-vjetorit të Pavarësisë, 26-vjetorit të Epopesë së UÇK-së

dhe 25-vjetorit të Çlirimit të Kosovës", thuhet në njoftim. Gjithashtu, qeveria ka publikuar edhe planin për aktivitete që do të mbahen me rastin e shënimit të 16-vjetorit të pavarësisë.





KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI, I ËSHTË DREJTUAR TË DIELËN ME NJË MESAZH KOMUNITETT SERB NË KOSOVË LIDHUR ME RREGULLOREN E RE TË BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS (BQK)

## Kurti: Nga 1 shkurti dinari nuk mund të kalojë kufirin me thasë, por vetëm përmes llogarive bankare

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) nuk ia ndalon Serbisë t'u ndihmojë serbëve të Kosovës dhe Kosova nuk e ka ndaluar dinarin sikurse asnjë valutë tjetër. duke iu referuar rregullores së BQK-së, e cila ka hyrë në fuqi më 1 shkurt, Kurti ka theksuar se kjo rregullore parasheh që valuta e vetme për kryerje të transaksioneve me para të gatshme është euroja. Për Kurtin, çdo interpretim tjetër i rregullores përbën fushatë mbi baza të rreme

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se me ndalimin e qarkullimit të dinarit serb, është ndaluar futja dhe transporti përtej kufijve që, sipas tij, u mundësonte grupeve kriminale ta forconin ndikimin mbi popullin dhe ta frikësonin duke i inkurajuar kriminelët nga shteti serb. "Të gjithë jemi të vetëdijshëm për fushatën e ngritur mbi baza të rrejshme kundër institucioneve të pavarura të themeluara me Kushtetutë, siç është Banka Qendrore e Kosovës, për hir të ruajtjes së mënyrave tashmë të konsoliduara të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke dërguar para të gatshme në thasë përmes

kufijve të Serbisë dhe Kosovës. Më 1 shkurt të këtij viti ka hyrë në fuqi rregullorja e Bankës Qendrore për pagesat me para të gatshme. Kjo rregullore nuk i referohet dinarit dhe as nuk e përmend atë si të tillë. Prandaj, synimi i Bankës Qendrore është formalizimi i pagesës dhe procedurat lidhur me të për dallim nga përpjekjet për të dëshmuar se qëllimi i saj është heqja e dinarit apo e ndonjë monedhe tjetër në Kosovë", ka thënë Kurti në një video të postuar në "Facebook". Ai ka thënë se Banka Qendrore tregon qartë se euro është mjeti i vetëm i pagesës në Kosovë dhe se në këtë drejtim çdo transaksion duhet të jetë në euro si valuta e vetme zyrtare në Kosovë. "Rregullorja e Bankës Qendrore nuk e ndalon Serbinë që të ndihmojë financiarisht qytetarët e

komunitetit serb në Kosovë. Çdo sugjerim për të kundërtën është propagandë e rreme që synon krijimin e tensioneve etnike. Rregullorja e Bankës Qendrore siguron ligjshmërinë dhe transparencën e parave të importuara në Kosovë, bazuar në Kushtetutën dhe politikën monetare të Bashkimit Evropian. Pra, Kosova nuk e ndaloi dinarin ashtu siç nuk e ndaloi as dollarin, as funtën dhe as frangun zviceran. I vetmi ndryshim është se nga 1 shkurti paratë nuk mund të kalojnë kufirin me thasë, siç nuk mund të bëhet në asnjë shtet demokratik, por mund të vijnë përmes llogarive bankare të tërhequra në euro. Kjo politikë mbron qytetarët nga kërcënimet e kriminit të organizuar, trafikimit me armë dhe pastrimit të parave. Deri

më tani mënyra e futjes dhe transportit të parave përtej kufijve u mundësonte grupeve kriminale të merrnin para të importuara ilegalisht, duke forcuar kështu ndikimin e tyre mbi popullin, duke frikësuar masat dhe duke inkurajuar kriminelët nga kreu i shtetit serb", është shprehur Kurti. Ai ka thënë se krimi duhet mposhtur, duhet të ndalet pastrimi i parave dhe pasurimi i paligjshëm me qëllimin e lehtësimit të financimit të terroristëve dhe pengimit të paqes. "Banka Qendrore e Kosovës i ka ofruar lehtësime për konvertimin e dinarëve në euro Bankës Popullore të Serbisë. Banka Qendrore e Kosovës ka siguruar hapjen e llogarive bankare në euro për ata që ende nuk e kanë bërë këtë, pa pagesë. Vetëm mendoni se sa mundësi do të krijohë hapja e një llogarie të rregullt bankare për një pjesë të vogël të popullsisë që nuk e ka bërë ende këtë: fluksi i parave përmes llogarisë do të mundësojë regjistrimin e pagesave dhe disbursimeve të ligjshme, të cilat do të jenë baza eventuale të marrjes së një kredie apo fillimit të një biznesi, marrja e

ndihmës nga institucionet e Kosovës, pavarësia ekonomike e grave, e cila në mënyrë të pashmangshme çon në mundësi të reja për një jetë më të mirë", është shprehur kryeministri Kurti. Ai ka thënë se Kosova ka krijuar skema të asistencës financiare dhe ndihmës sociale për familjet në nevojë, gratë lehona dhe nënat me fëmijë. "Kjo lloj ndihme nuk do të përfundojë kurrë dhe vetëm do të rritet, në përputhje me rritjen ekonomike dhe planifikimin buxhetor. Çdo muaj më shumë se 33 000 pjesëtarë të komunitetit serb marrin pensione nga Republika e Kosovës, 2 205 familje marrin ndihmë sociale, 4 244 familje marrin ndihmë për fëmijë dhe 1 372 familje marrin ndihmë për gratë lehona dhe nënat me fëmijë. Gjithçka përmes llogarisë bankare të hapur në euro", ka thënë ai, duke shtuar se përmes tyre mund të merret edhe ndihma për komunitetin serb, e dërguar nga Qeveria e Beogradit, e pranuar në euro dhe e regjistruar përmes llogarisë bankare për hir të transparencës dhe vendosjes së ligjshmërisë. "Në këtë mënyrë shuma e parave të dërguara nga

# Universiteti i Prishtinës me libra të vjetër dhe pa qasje në revista shkencore

PRISHTINË, 11 SHKURT - Nga viti 1968 e deri në vitin 2013. Me librat e publikuar gjatë kësaj kohe shërbehen qindra studentë nëpër disa fakultete të Universitetit të Prishtinës.

Shumë prej programeve të studimit në këtë universitet publik nuk i kanë publike syllabuset e lëndëve. Por, disa prej tyre - në Fakultetin Ekonomik dhe atë Juridik, si dhe në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) - mund të gjenden online.

Në syllabusin e publikuar online për lëndën Kompjuterikë në FIEK, libri i përshkruar për "artin e programimit kompjuterik" është publikuar në vitin 1999.

Përkundër që vitet e fundit fusha e shkencave kompjuterike është zhvilluar hovshëm - duke çuar edhe në paralajmërime për rreziqet nga inteligjenca artificiale - studentëve u përshkruhet material rreth 25 vjet i vjetër.

Njohësja e zhvillimeve në fushën e arsimit, Arbisa Shefkiu, thotë se gjendja në UP sjell "shqetësime të thella dhe sfida", të cilat, sipas saj, nuk po adresohen me seriozitet nga menaxhmenti. "Mungesa e burimeve shkencore dhe literaturës adekuate në bibliotekat e fakulteteve paraqet një pengesë serioze për zhvillimin e njohurive dhe krijimin e një mjedisi të pasur akademik", thotë Shefkiu për REL-

in.

Ajo beson se rekomandimet e Agjencisë Kosovare për Akreditim të vitit 2020, sipas të cilave duhet të rriteshin investimet në hulumtime, të përmirësoheshin burimet shkencore dhe të zgjeroheshin bashkëpunimi ndërkombëtar, janë ende relevante dhe "të domosdoshme për ta përmirësuar cilësinë e arsimit në UP".

"Në këtë kontekst, është e nevojshme që universiteti të kthehet drejt adresimit të këtyre sfidave për të siguruar një mjedis të pasuruar akademik dhe zhvillim të studentëve. Përmirësimi i këtyre aspekteve do ta kthejë UP-në në një qendër të pasuruar dhe inovative për të gjithë komunitetin", thotë Shefkiu.

## Studentët, me përshtypje të ndryshme për literaturën

Radio Evropa e Lirë vizitoi FIEK-un të enjten, kur studentët të pranishëm shprehën mendime të ndryshme për literaturën që u jepet për të studiuar. Një gjë që kishin të përbashkët ishte dëshira për të mbetur anonimë, nga frika se profesorët mund t'u hakmerren në notë. "Literatura është llom", tha një ndër studentët që po qëndronte para dyerve të

fakultetit.

Një tjetër grup i djemve thanë se, në fakt, literatura e përmendur në syllabus nuk përdoret fare dhe se ata mësojnë nga materialet që i paraqesin profesorët gjatë ligjëratave.

Asnjëri prej studentëve me të cilët foli REL-i nuk ishte në dijeni për revistat e ndryshme shkencore për fushat e tyre të studimit, por disa thanë se mendojnë se literatura është adekuate për mësimet bazë që marrin në fillim të studimeve.

Universiteti publik në Milton Keynes të Anglisë, Open University, i cilëson revistat shkencore si "burimi i preferuar të informacionit akademik". "Ato zakonisht ofrojnë një perspektivë më aktualen sesa librat shkollorë dhe kanë besueshmëri për shkak të procesit të rishikimit nga kolegët. Artikujt e revistave [punimet] të paraqitur nga studiues, vlerësohen nga ekspertë të fushës përpara se të publikohen", thuhet në uebfaqen e këtij universiteti.

Radio Evropa e Lirë pyeti në Zyrën e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës se pse nuk është bërë abonimi me pagesë në revista shkencore ndërkombëtare, por nuk mori përgjigje.

As nga FIEK-u nuk pranuan ta komentojnë literaturën që u caktohet studentëve.

Sipas syllabuseve të publikuara në

uebfaqet e fakulteteve të UP-së, as artikujt shkencorë të publikuar nëpër revista shkencore të qasshme pa pagesë nuk janë të përfshirë në planet e studimit.

## Abonimet e shtrenjta

Rreth pesë vjet më parë Universiteti publik i Kalifornisë në ShBA kishte ndaluar abonimin në një prej publikuesve më të famshëm të hulumtimeve akademike, Elsevier, për shkak të çmimit të lartë.

Deri në vitin 2019 Universiteti i Kalifornisë kishte paguar rreth dhjetë milionë dollarë në vit për këtë abonim.

Abonimet në publikues të tillë si Elsevier, që ka në pronësi mijëra revista shkencore, u mundësojnë shpeshherë akademikëve edhe t'i publikojnë hulumtimet e tyre në to, e jo vetëm qasje për hulumtim. Universiteti i Prishtinës prezantohet si "baza kryesore e kërkimit shkencor në vend", mirëpo nuk ka ndonjë abonim të tillë.

Buxheti i Universitetit të Prishtinës, sipas buxhetit të vitit 2024, do të jetë gati 32 milionë euro gjithsej, rreth një milion euro më pak sesa vitin e kaluar.

Rreth 30 milionë euro vijnë nga grantet qeveritare, ndërsa pjesa e mbetur janë të hyra vetjake të UP-së.

Projektet e planifikuara për këtë vit përfshijnë ndërtimin e një laboratorit si dhe ndërtimin dhe renovimin e objekteve të disa fakulteteve.

Këshilli drejtues i UP-së - ku Ministria e Arsimit emëron katër anëtarë sipas Ligjit mbi arsimin e lartë - i raporton Ministrisë së Financave për shfrytëzimin e buxhetit të ndarë për universitetin. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit (MASHIT) nuk u përgjigj në pyetjet e REL-it lidhur me cilësinë e arsimit në UP dhe buxhetin e këtij institucioni.

## Dallimi me studimet jashtë Kosovës

Një studente e Fakultetit të Filologjisë nga Prizreni ka fituar dy herë bursë nga një program i Bashkimit Evropian, Erasmus Mundus, i cili u mundëson studentëve t'i vazhdojnë studimet në ndonjë universitet në Evropë për një kohë të caktuar.

Gjatë studimeve të saj - në nivelet Bachelor dhe Master - atë e befasuan shumë gjëra. Diçka që i mbetet në mendje është përshtypja se tani është më shumë se vetëm një "nxënëse", e krijuar nga studimet jashtë UP-së. "Për shkak të licencës dhe autorizimit nga universiteti ku studiova në Gjermani, kam pasur qasje në qindra artikuj dhe libra, pa pasur nevojë t'i blej ato. Universiteti ofron edhe mundësinë e bibliotekës online, me një numër shumë të madh të librave e artikujve shkencorë. Në UP kjo mungon, fatkeqësisht", thotë ajo për REL-in.

Prizrenases i kanë pëlqyer edhe shumë aspekte të tjera të studimit jashtë UP-së, si shumëllojshmëria e lëndëve dhe qasja e hershme në materialet mësimore për të gjithë semestrin.

Për studimet e saj në UP ajo sheh një të mirë. "Nuk ka edhe aq shumë studentë. Në këtë mënyrë ti mund të krijosh rrjete që mund të të ndihmojnë në të ardhmen. Vetë profesorët, nëse je student i mirë, të inkurajojnë të vazhdojnë më tutje", thotë ajo.

Universiteti i Prishtinës aktualisht ka pak mbi 6 000 studentë, rreth 68 për qind e të cilëve janë vajza.



Beogradi do të përputhet saktësisht me paratë që do të merrni në Kosovë. Ne do të bëjmë gjithçka që është në fuqinë tonë përmes fushatave informuese dhe mundësimit të lehtësimit, me synimin për një tranzicion të lehtë. Gjëja më e rëndësishme është të kuptohet dhe besohet se vendosja e shtetit ligjor është e pashmangshme, dërgimi i parave përmes transaksioneve bankare është i pakompromis dhe gëzimi i të drejtave të fituara deri më tani në mënyrë të lirë, nga autoritetet shtetërore në Kosovë, është një pjesë e domosdoshme e

garantimit të lirisë së të gjithë qytetarëve për të marrë çdo ndihmë financiare nga cilado palë apo autoritet që vjen përmes rrugëve ligjore", ka deklaruar Kurti. Kurti ka thënë se mirëqenia edhe e familjeve është forca shtytëse e veprimeve të qeverisë por, sipas tij, mbi të gjitha, prioriteti i qeverisë është të sigurojë mirëqenie dhe asistencë sociale aty ku nevojitet, për të gjithë qytetarët e saj, pavarësisht prej përkatësisë së tyre etnike.


"Ju jam drejtuar shumë herë dhe kam theksuar se qeveria që e drejtoj është qeveria e të gjithë

neve dhe Republika jonë është shtëpia e të gjitha komuniteteve që jetojnë këtu. Lufta, dhe më pas politika e gabuar e politikanëve që ishin në krye të shtetit, lanë pas popullin pa përkujdesje, të varfër dhe të ekspozuar ndaj organizatave dhe bandave kriminale, derisa kujdeseshin për jetën luksoze të tyre dhe atyre që bashkëpunuan me ta", është shprehur ai.

Ai ka thënë se gjatë tre viteve të fundit si qeveri kanë bërë të pamundurën për të luftuar krimin me hapa të mençur, politikë të bazuar në vendosjen e ligjit dhe

sundimin e ligjit. "E ngritëm vendin tonë në një nivel më të lartë të demokracisë, që nënkupton edhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe qytetarit, e që u njoh edhe nga organizata prestigjioze Freedom House e më vonë edhe nga Transparency International për luftën kundër korrupsionit, si dhe nga World Justice Project si rezultat i respektimit dhe sundimit të ligjit. Kjo vetëm tregon se sa mundemi dhe duhet, së bashku, si një shtet multikulturor dhe multietnik i ndërtuar mbi postulatet e respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirisë

themelore, demokracisë dhe mundësive të barabarta për të gjithë dhe ndaj të gjithëve. Si një popull që është përpjekur për liri me shekuj dhe si shtetësi e të gjithëve që dëshirojnë paqe dhe prosperitet, ne duhet të tregojmë besim të njëri-tjetri për të ecur përpara fuqishëm e me vendosmëri dhe kështu ta mposhtim krimin, urrejtimin fetar, racore dhe etnike, ndarjen e shoqërisë dhe lajmet e rreme, të nevojshme për arritjen e qëllimeve nacionaliste dhe shoviniste dhe fitoret e ngushta politike", ka thënë Kurti.



## Sistemi i drejtësisë së Hagës



Shkruan: Sali BISLIMI

Siç është theksuar shumë herë, drejtësia e Hagës neglizhon të drejtat e mbrojtjes dhe parimin e procedurës së hapur.

Paqartësia e seancave, të mbyllura për publikun, përforcojnë ndjenjën e dyshimit për drejtësi të paanshme dhe egalitare.

Dhomat e Posaçme të Kosovës, të ngarkuara për gjykimin e ish-çlirimtarëve të kombit, në Hagë, kanë humbur legjitimitetin e tyre aktual, pasi në të njëjtën kohë gjykatat e zakonshme në Prishtinë po gjykojnë raste identike të lidhura me krimet e luftës gjatë periudhës 1999-

2000, pa ngjallur as më të voglin sfidë nga autoritetet evropiane apo ndërkombëtare.

Si mund të justifikojmë dy juridiksione të ndryshme, njëra e vendit, tjetra ndërkombëtare, të merren me të njëjtën gjendje kriminale? Me fjalë të tjera, disa shtete perëndimore i frikësoheshin sistemit të drejtësisë së Kosovës si të korruptuar “abovo” dhe e zhvendosën drejtësinë “legjitime” në Hagë, ndërsa pranuan për fakte të ngjashme (luftën për pavarësinë e Kosovës), juridiksionin e gjykatave të Prishtinës.

Asnjë shpjegim i arsyeshëm ligjor nuk mund të mbështesë një mosfunksionim të tillë aktual, autoritetet politike kosovare në vend, por edhe shtetet perëndimore që qëndrojnë pas Dhomave Speciale të Kosovës, duhet ta denoncojnë këtë drejtësi pseudohibride dhe në kundërshtim me një gjykim dinjitoz dhe të drejtë!

*(Autori është drejtor i “Zërit Perëndimor të Kosovës” dhe drejtor i zyrës ligjore First-consulting.ch në Bern dhe Delémont të Zvicrës)*

## Tentim-atentati ndaj Kurtit, reagon Ismaili: Plasimi i lajmeve të tilla pa vërtetësinë e duhur, ndjellakeqe për shoqërinë

PRISHTINË, 11 SHKURT - Ish-deputetja e Kuvendit të Kosovës, Besa Ismaili, ka reaguar në lidhje me raportimet se ka pasur një tentim atentat ndaj kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në Shkup. Ajo ka shkruar në “Facebook” se lajmet për plane për vrasje të politikanëve janë shqetësuese për të. “Qoftë edhe si lajme të rrejshme, mua si Besë më shqetësojnë! Unë, si edhe shumë nga ata që i njoh, nuk e duroj as të dëgjoj, as të shoh e të lexoj për këto tema, përpos në platforma si ‘Netflix!’ Konsideroj se është jetike që institucionet tona me urgjencë ta vlerësojnë

kredibilitetin e informacionit të paraqitur në media në lidhje me pretendimet e sotme në raport me kryeministrin e Kosovës dhe vizitën në Shkup. Plasimi i lajmeve të tilla, pa qartësinë dhe vërtetësinë e duhur janë ndjellakeqe për shoqërinë. Të vërteta apo të rrejshme, pa paragjykim nga ana ime, ato përhapin dyshim, frikë, armiqësi dhe paragjykim”, ka shkruar ish-deputetja Ismaili. Ajo ka thënë se institucionet e shtetit dhe mediet duhet ta kenë kujdesin e duhur në trajtimin e tyre.

“Kur institucionet shtetërore të sigurisë bëjnë punët e tyre siç

duhet, qytetari kursethet nga lajmet të tilla. Kosova duhet të ndërpresë spiralen e instrumentalizimit dhe profiterizimit politik me temën e vrasjeve dhe tentimvrasjeve të individëve, që për së paku këto tri dekadat e fundit kanë ulçerizuar tej mase shpirtin e shoqërisë tonë. Mjaft është mjaft”, ka shkruar Ismaili.

Ministria e Punëve të Brendshme në Maqedoninë e Veriut ka theksuar se gjatë vizitës së kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në Shkup, nuk ka pasur asnjë tentim për atentat ndaj tij. “Sa i përket sigurisë gjatë



vizitës së kryeministrit Kurti, ajo është e organizuar sipas rregullave të paracaktuara dhe

vlerësimeve të sigurisë”, ka thënë zëdhënësi i MPB-së, Toni Angellovski.

## Hoxhaj merr pjesë në Samitin Botëror të Qeverive në Dubai

PRISHTINË, 11 SHKURT - Ish-zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, do të marrë pjesë në Samitin Botëror të Qeverisë, i cili po zhvillohet në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe. Samiti Botëror i Qeverisë është një platformë për qeveritë e mbarë botës, ku marrin pjesë dhe angazhohen në diskutime globale mbi formësimin e së ardhmes së njerëzimit.

Ish-ministri i Jashtëm, aktualisht nënkryetar i Kuvendit, Enver Hoxhaj, është ftuar të marrë pjesë në këtë Samit nga Ministri i Shtetit për Inteligjencën Artificiale, Ekonominë Digjitale dhe Aplikimet e Punës në Distanca, i Emirateve të Bashkuara Arabe, Omar Sultan Al Olama.

Enver Hoxhaj përmes një shkrimi në rrjetin social



“Facebook” ka treguar se do të marrë pjesë në këtë Samit, i cili

këtë vit trajton temën e qeverive të së ardhmes, sfidat gjeopolitike dhe ekonomike, si dhe shkëmben ide për t'i fuqizuar gjeneratat e ardhshme të qeverive në tërë botën. “Bashkë me shumë liderë të qeverive të shteteve të ndryshme, organizata ndërkombëtare e ndërmarrës botërore, jam i ftuar të marr pjesë në Samitin Botëror të

Qeverisë, i cili këtë vit trajton temën e qeverive të së ardhmes, sfidat gjeopolitike dhe ekonomike, si dhe shkëmben ide për t'i fuqizuar gjeneratat e ardhshme të qeverive në tërë botën”, ka shkruar Hoxhaj. Hoxhaj edhe në vitet e kaluara ka qenë pjesëmarrës në këtë samit botëror, i cili ka trajtuar tema të rëndësishme gjeopolitike dhe ekonomike globale.

## Prishtina përballet me erëra të forta, mbi 12 raste të intervenimeve

Prishtinë, 11 shkurt - Erërat e forta që kanë filluar qysh mbrëmë kanë shkaktuar dëme të mëdha materiale në kryeqytet.

Drejtori për Siguri dhe Emergjencat në komunën e Prishtinës, Lulzim Fushtica, ka thënë për “Telegrafi”-n se prej së shtunës në mbrëmje janë mbi 12 raste që kanë intervenuar. “Prej mbrëmje janë mbi 12 raste që kemi

intervenuar në pothuajse të gjitha pjesët e qytetit duke filluar nga lagjja Arbëria, Rrugën B, Bregu i Diellit, Dardania” etj.

Ai ka shtuar se në fshatin Prugoc të Prishtinës dëmet janë më të mëdha, ndërsa ka theksuar se, fatmirësisht, përveç dëmeve materiale, nuk ka të lënduar. Fushtica u ka bërë thirrje qytetarëve të kenë kujdes të shtuar dhe t'i shmangin daljet,

sidomos rreth parqeve, për shkak të rrezikut nga rënia e degëve.

Drejtorja për Siguri dhe Emergjencat ka izoluar edhe zonën rreth objektit të kryeqytetit në lagjen “Arbëria” në Prishtinë për të parandaluar ndonjë fatkeqësi të mundshme nga erërat e forta të paralajmëruar nga 20 deri në 80 km/h të cilat do të sjellin edhe dëme materiale.



# Faturat e mistershme: Kush po e paguan rrymën në veri?



**PRISHTINË, 11 JANAR** - Qytetarë të katër komunave të banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës thonë se nuk kanë pranuar fatura të energjisë elektrike për muajin janar, ani pse Qeveria e Kosovës tha se në atë zonë, ku rryma nuk paguhet tash e 25 vjet, janë shpërndarë rreth 20 mijë të tilla.

Rafael Ralloviq nga Leposaviq - rreth 70 kilometra larg Prishtinës - thotë se ka rreth pesë vjet që në shtëpinë e tij e ka të instaluar njëshorin që mat shpenzimin e energjisë elektrike. "Matësi im i rrymës është relativisht i ri, por se sa funksionon saktësisht nuk e di", thotë Ralloviq.

Ai tregon se nuk ka pranuar asnjëherë faturë për shpenzimin e rrymës, por se ka pritur që për janarin e kaluar të ishte ndryshe për shkak të paralajmërimeve nga autoritetet e Kosovës se rryma do të faturohet. "Para një muaji kanë ardhur dhe kanë regjistruar gjendjen e matësve të energjisë elektrike. Tani askush nuk erdhi më. Nuk e di se si është situata", thotë Ralloviq për Radion Evropa e Lirë.

Në Leposaviq dhe në tri komunat e tjera me shumicë serbe në veri të Kosovës - Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok e Zvečan - banorët nuk e kanë paguar rrymën që nga paslufta më 1999.

Refuzimi ka ndodhur si pasojë e mosbindjes qytetare, por edhe ndikimit të strukturave të

ndryshme atje, që kanë operuar nën dirgjimin e Serbisë.

Ndër vite, shpenzimet e bëra në veri janë paguar nga qytetarët e komunave të tjera të Kosovës, ndërsa nga viti 2017 e këndeje nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut i Kosovës (KOSTT) dhe nga subvencionet e Qeverisë së Kosovës.

Për ta zgjidhur këtë çështje, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje në vitin 2013, por ajo nuk u zbatua me vite, derisa dy vendet ranë dakord për një udhërrëfyes për zbatimin e saj në vitin 2022.

Me këtë udhërrëfyes, obligimin për furnizimin dhe faturimin e energjisë elektrike në veri e mori kompania serbe "Elektrosever", e cila u pajis me licencë të operimit në Kosovë po atë vit. Pavarësisht prej kësaj, gjendja nuk ndryshoi deri më 1 janar të këtij viti, kur KOSTT-i lajmëroi se që nga kjo kohë e këndeje "energjinë e konsumuar në pjesën veriore të Kosovës, të banuar me shumicë serbe, do të paguhet njësoj sikurse në pjesën tjetër të shtetit".

KOSTT-i tha atëkohë se "Elektrosever"-i "ka filluar ta marrë përgjegjësinë për konsumin e energjisë në veri".

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, gjatë raportimit në një komision parlamentar më 26 janar, tha se "mbi 20 mijë fatura janë shpërndarë në veri

për konsumin e energjisë gjatë muajit janar".

## "Nuk kemi fatura"

Pavarësisht prej deklaratës së Bislimit, disa qytetarë të anketuar nga Radio Evropa e Lirë në komunat në veri thonë se nuk kanë pranuar asnjë faturë. "Nuk e kemi marrë faturën e energjisë elektrike. Flitet për këtë prej muajsh. Ka lloje të ndryshme informacionesh ose keqinformimesh", thotë Snezhana Ratkoviq nga Leposaviq.

Ajo thotë se ka një matës të vjetër të rrymës dhe se ka dëgjuar se "do të vendosen matës të rinj dhe, pastaj, do të fillojë të paguhet energjia elektrike".

Faturë nuk mori as Nenadi, qytetar nga Mitrovica e Veriut, rreth 30 kilometra larg Leposaviqit. "Po presim [matës] të rinj, sepse ka fjalë që do të fillojë faturimi i energjisë elektrike. Nuk ka tjetër informacion në media apo në mesin e njerëzve. Askush [nuk ka pranuar faturë] në ndërtesën time", thotë ai.

Të tjerë qytetarë nga Mitrovica e Veriut thonë, po ashtu, se nuk kanë marrë fatura dhe se nuk kanë informacione në lidhje me pagesën eventuale të rrymës. Në veriun e Kosovës nuk dihet saktë numri i konsumatorëve të energjisë elektrike.

Qeveria e Kosovës dhe KEDS-i,

që është kompania përgjegjëse për furnizim me energji elektrike, i thanë Radios Evropa e Lirë se deri më tani janë regjistruar rreth 20 mijë konsumatorë në bazë të njehsorëve që ekzistojnë atje. Megjithatë, në atë zonë ka edhe ndërtesa që nuk kanë të instaluar fare matës të energjisë elektrike ose kanë matës jofunksionalë.

Sipas Udhërrëfyesit për Zbatimin e Marrëveshjes për Energjinë të vitit 2022, është e paraparë që KEDS-i ta bëjë vendosjen e njehsorëve të rinj në atë zonë. Kjo kompani tha se pret nga "Elektrosever"-i që "të përpilojë një plan investiv, bashkë me kostot e kërkuara të mirëmbajtjes, të cilat KEDS-i i dorëzon pastaj në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë për aprovim".

Klismen Kadiu nga Zyra e zëvendëskryeministrit Bislimi tha për Radion Evropa e Lirë se për financimin dhe blerjen e njehsorëve të rinj ka shprehur interesim Bashkimi Evropian. BE-ja nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it në lidhje me këtë çështje.

## Kush po e paguan aktualisht rrymën në veri?

As Qeveria, as KOSTT-i dhe as Bashkimi Evropian, që ishte ndërmjetësues i Marrëveshjes për Energjinë, nuk iu përgjigjën kësaj pyetje.

Zyra e Rregullatorit për Energjinë (ZRRE) i tha REL-it se furnizuesi (në këtë rast "Elektrosever"-i) "është i obliguar t'i faturojë dhe t'i arkëtojë pagesat prej konsumatorëve". "Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të fatuar për energjinë e shpenzuar me llojin e tarifës së dakorduar", thanë nga ZRRE-ja.

Kjo zyrë, po ashtu, sqaroi se nëse ndonjë nga konsumatorët nuk ka njehsor të energjisë elektrike apo matësi i tij nuk është funksional, atëherë ai do të duhej të nënshkruajë një kontratë për furnizim. "Dhe, pastaj, KEDS-i duhet t'i instalojë/ndërrtojë njehsorët elektrikë, në mënyrë që konsumatorët të kenë matje të shpenzimit të energjisë elektrike", shpjegoi ZRRE-ja.

"Elektrosever"-i është në pronësi të kompanisë energjetike të Serbisë - EPS ("Elektroprivreda Srbije"). Kjo kompani nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it në lidhje me faturimin dhe pagesën e energjisë elektrike në veri të vendit.

Sipas të dhënave zyrtare, nga viti 2010 deri në vitin 2022 për rrymën e shpenzuar në veri janë paguar gjithsej 237 milionë euro (mesatarisht 19 milionë euro në vit).

Kostoja e rrymës është rritur ndjeshëm nga viti 2021 për shkak të rritjes së përgjithshme të çmimeve të energjisë si pasojë e krizave të ndryshme globale.

# Avni Rustemi në Kuvend, më 1924: Mos qeshni kur përmendet Lenini



## Nga: Kastriot DERVISHI

Më 4 shkurti 1924 në Kuvendin Kushtetues të Shqipërisë (kati i dytë i Akademisë së Shkencave sot), në fillim të mbledhjes deputeti Rauf Fico propozoi mbajtjen e zisë për nder të presidentit amerikan [Woodrow] Wilson, si një detyrim moral ndaj përkushtimit të tij ndaj çështjes shqiptare. Fill pas mbajtjes së kësaj zie, deputeti Jashar Erebara – sekretar i Kuvendit, i shtyrë nga Avni Rustemi – në pushim të seancës kërkoi mbajtjen e zisë edhe për Leninin meqë sipas tij ai paska qenë për një “Shqipëri të Madhe”. Kërkesa e Erebarës shkaktoi një ilaritet në sallë për faktin se Lenini ishte bolshevik dhe se të gjithë e dinin se ky propozim nuk ishte i tij. Në këto kushte për të mbrojtur drejtpërdrejt këtë propozim, e mori fjalën vetë Avni Rustemi. Fjala e tij, nga historiografia komuniste është interpretuar sikur ai i imponoi Kuvendit Kushtetues mbajtjen e zisë për Leninin. Ndërsa, në një film artistik kushtuar Avni Rustemit, jepet në krahun tjetër të sallës Ahmet Zogu i inatosur. Në fakt kjo i bën nder Ahmet Zogut, por e vërteta është se sipas procesverbalit të mbledhjes, ai

nuk ka qenë i pranishëm në këtë seancë, por është shprehur kundër këtij propozimi jashtë Kuvendit Kushtetues kur çdo gjë kishte mbaruar. Nga sa kuptohet në fjalët e deputetëve, zia në Kuvendin Kushtetues nuk është mbajtur për Leninin, por për Vani Cico Kosturin, familjes të të cilit i është dërguar edhe një telegram.

\*\*\*

### Mbledhja e 7-të e Kuvendit Kushtetues. E hënë 4 shkurt 1924

(Deputetët që mungonin: Ahmet Zogu, Aqif Elbasani, Fahri Rashid, Faik Konica, Ferid Vokopola, Hoxha Kadri, Izet Didra, Jan Papadhoppulo, Kostaq Kotta, Kostaq Paftali, Kristaq Kosturi, Lon Llogori, Milto Tutulani, Nikollaq Zoi, Pandeli Evangjeli, Sami Vrioni, Shazivar Alltuni, Terenc Toçi)

**RAUF FICO:** Zoti kryetar! Pa hyrë në bisedimin e rendit të ditës, dua të bëj një propozim. Me hidhërim morëm vesh se ish-kryetari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, W. Wilsoni, vdiq. Duke marrë parasysh shërbimet e mëdha që i ka bërë Shqipërisë, propozoj të bëhen pesë minuta pushim si shenjë hidhërimi edhe t'i hiqet një telegram ngushëllimi

familjes së të ndjerit.

(Pranohet. Bëhen 5 minuta pushim dhe pas 5 minutash mbledhja mblidhet prapë).

**JASHAR EREBARA:** Para se të hymë në bisedim, propozoj të bëhen pesë minuta pushim edhe për Leninin, se në qoftë se Willsoni do të flitëte për të mirën e Shqipërisë, ma tepër do të flitëte Lenini për një Shqipëri të madhe.

(Ilaritet në sallë)

**AVNI RUSTEMI:** Më vjen shumë keq zoti kryetar që kur përmendet emri i Leninit dëgjohen qeshje nga ana e disa përfaqësuesve të kombit. Nuk dua që Shqipëria të jetë bolshevike, sepse gjendja dhe pozita e saj nuk e do, por për principet e larta njerëzore duhet që me një respekt të zihet në gojë emri i tij. E dini fare mirë zotërinj, se qysh ai mbrojti principet e larta të njerëzisë e se që i pari që denoncoi traktatin e fshehtë të 1915-ës që ishte për copëtimin e Shqipërisë. E dija se propozimi i bërë prej zotni Erebarës nuk do të pranohej, por neve megjithatë e kemi për detyrë të propozojmë që të bëhen pesë minuta pushim si shenjë hidhërimi për vdekjen e tij.

**EQREM VLORA:** Për nderin e kaq mijë shpirtave që theri me duar të tija?

**ALI KËLCYRA:** Zoti kryetar! Në

këtë rast që po nisim të bëjmë pesë minuta pushim për njerëz të huaj, më duket se do të ishte më e drejtë të bëjmë edhe pesë minuta pushim për ata që kanë derdhur gjakun për krijimin e Shqipërisë e që këtë tokë e kanë vaditur me gjakun e tyre. Mbasi sot po shkojmë nga jeta në armiqësi dhe e intrigave

fqinjore, propozoj të bëhen pesë minuta pushim për Vani Cico Kosturin, të cilit i kanë dekë të vrarë i biri nga ana e grekëve dhe i nipi nga ushtria turke dhe t'i hiqet një telegram ngushëllimi familjes së tij.

(Bëhen pesë minuta pushim dhe pas pesë minutash



B I S E D I M E T

E

KUVENDIT KUSHTETUES

Mbledhja e VII.

E Hane me 4. Fruer 1924. ora 3 m. dr.

U kënduene emnat Z. Z. misve Kryetar! Kam të flas ca fjalë mbi pro-



# Zef Valentini dhe studimet për Onufrin

Nga: Ndrëçim KULLA


At Zef Valentini, edhe pas vitit 1944, megjithëse nuk mund të shkelte dot në Shqipëri – ku e kishin etiketuar si kriminel – ndiqte me vëmendje të gjitha botimet shkencore albanologjike që bëheshin nga studiuesit shqiptarë dhe nuk mungonte t'i vlerësonte kur ishte rasti.

Një shembull për këtë është studimi i tij "Saktësime rreth piktorit shqiptar gjysmëbizantin, Onufri" (Revista "Shejzat", 1962, nr. 5-6, f. 183-184) ku ai merr shkas nga punimet e dy studiuesve në Shqipëri për Onufrin, që të shprehte disa pikëpamje shumë të vlefshme mbi veprën e piktorit. Si studiues i ikonografi së bizantine, At Valentini e kishte studiuar thellësisht edhe veprën e Onufrit. At Valentini shkruan në studimin e përmendur më lart:

*Kohët e fundit, për meritë të Viktori Puzanovës dhe të Theofan Popës [1] u soll në vëmendje dhe u hodh dritë rreth figurës së këtij piktori, ndër piktorët më të shquar shqiptarë si dhe të birit të tij Nikolla, i cili trashëgoi artin e të atit. Nga kërkimet e kryera nën kujdesin e Institutit të Shkencave të Tiranës dhe nga botimet e dy studiuesve të përmendur, në mënyrë të veçantë nga i dyti, i cili ka dhënë ndihmesën më të madhe historike, do të rezultonte sa më poshtë: Onufri ka punuar në Shpat të Elbasanit dhe më saktësisht në Shën Nikolla të Shelcanit në afresket e nënshkruara dhe në Shën Veneranda të Valëshit në afresket po ashtu i nënshkruan, por me cilësinë e "protopapas i Neokastras" (Elbasan) dhe që datonin në vitin 1554; përveç kësaj, nga identiteti i stilit, Th. Popa del në përfundimin që edhe afresket e Shën Theodorit në kështjellën e Beratit do të jenë bërë nga e njëjta dorë, çka ngjan patjetër e mundshme, të paktën përse mund të argumentohet nga riprodhimet më të dobëta, të dhëna në botimet e cituara; Nikolla ka punuar, çka e dimë, vetëm në Blakerne të Beratit në vitin 1578 dhe në Kurjan të Fierit dhe në mbishkrimet e dy figurave të plota si "i biri i Onufrit". [2]*

Pas vlerësimit që u bën dy studiuesve nga Shqipëria, At Valentini u bën atyre vërejtje të një niveli shumë të lartë akademik që meritojnë të merren në konsideratë nga çdo studiues serioz i Onufrit dhe që e bëjnë studimin e tij të nevojshëm për t'u përfshirë në çdo bibliografi të studimeve mbi Onufrin. At Valentini shkruan:

*Por, edhe te Th. Popa, ndonëse pse kaq mendjempërt dhe i pasur në hipoteza për të plotësuar biografinë e artistit të tij, duhet të*



*bëjmë vërejtje, nëse është rasti ta bëjmë pikërisht personale, lidhur me mbylljen e zakonshme të shkrimtarët e gjerë që janë të detyruar të jetojnë nën disa regjime përballë kaq shumë fondesh informacioni. Në rastin aktual, Th. Popa tregon se nuk ka mundur të ketë njoftime përse i takon veprimtarisë së Onufrit në Kishën e SS. Apostoli të Gjergj Zozas në Kastoria, çka munda ta nxirrte nga ORLANDOS [3] duke përfshirë të paktën 31 kuadro afreske. Prej tyre, në mënyrë të veçantë nga Orlandos, mund të nxjerrim njoftime për epigrafi në (mjerisht e ruajtur keq), është si më poshtë, e dyanshme:*

ΕΤΕΛΕΙΩΘΗ ΕΝΙ ΕΤΟΥΣ ΑΔΑΜ, ΖΝΕ' ΙΝΔ. Ε' ΑΠΟ ΔΕ ΤΗΣ ΕΝΣΑΡΚΟΥ ΟΙΚΟΝΟΜΙΑΣ ΤΟΙ ΚΥΡΙΟΥ ΗΜΩΝ ΙΗΣΟΥ ΧΡΙΣΤΟΥ ΑΦΜΖ' ΙΟΥΛΙΩΚΙ ... ΙΣΤΟΡΙΘ ΔΓ' ΟΝΟΥΦΡΙΟΥ ΑΡΤΙ ΕΚ ΤΗΣ ΛΑΜΠΡΟΤΑΤΗΣ ΠΟΛΕΟΝ ...

[Ky tempull] u përfundua në vitin 7055 të Adamit, udhëzimi V dhe nga ekonomia e Rimshërimit të Jezu Krishtit 1575, korrik 23 ... U pikturua nga Onufri kohët e fundit [i ardhur] nga

"Iamprotatis", qyteti i ... Emri i qytetit, në shekullin e kaluar, kur mbishkrimi ishte i ruajtur më mirë, u lexua nga Christides, si ΓΡΕΒΕΝΙΟΝ, ndërsa Orlandos, të cilin po e citoj, e lexon ΒΕΝΕΤΙΟΝ, i ndikuar nga epiteti ΛΑΜΠΡΟΤΑΤΗΣ ΠΟΛΕΟΝ (ΠΟΛΕΩΝ), i cili mbahet i aplikueshëm vetëm në Venecia, qyteti më i shkëlqyer ndër gjithë qytetet. [4] Nga këto fjalë të At Valentinit kuptohet se ai ishte një njohës shumë i thellë i greqishtes mesjetare kishtare, një njohës i thellë i kronologjisë kishtare bizantine dhe postbizantine, përveçse i ikonografi. Është për të ardhur keq që dy studiuesit e

Onufrit në Shqipëri nuk mundën të përfitojnë nga këto mendime të kolegut të tyre të shumëditur në Palermo. Të dy, si Theofan Popa ashtu dhe Puzanova (një ruse e bardhë e vendosur në Shqipëri) kishin njohje personale me At Valentinin që nga koha kur ai kishte jetuar dhe punuar në Shqipëri dhe do t'i kishin mirëpritur vërejtjet dhe sugjerimet e tij. At Valentini nuk kërkon që ta tjetërsojë nga kultura shqiptare Onufrin dhe veprën e tij, duke zbuluar ndikime të theksuara latine tek ai. At

**Valentini pranon se:**

*Por, ne nuk e dimë se si ta vendosim një piktor të tillë midis venecianëve të bizantinizuar të epokës, aspak ndër të ashtuquajturit kretesë, të cilët punonin në Venecia, jo besnikë siç ishin ndaj rregullave të pikturës bizantine, shumë më pak të rafi nuar se Onufri ynë. [5]*

Në qoftë se At Valentini do të kishte pasur si mision që të shpallte me ndikim latin dhe italian çdo gjë në traditën dhe kulturën shqiptare, siç e kanë përgojuar, ai nuk do të hezitonte që të bënte kështu edhe me Onufrin. Por, në vend që të bëjë këtë gjë, At Valentini sillte si shkencëtar serioz, siç e kam cituar më lart. At Valentini nuk e shikon Onufrin si një bizantin të latinizuar, por si një ekumenist të hapur ndaj ndikimeve artistike nga Perëndimi. At Valentini arrin në përfundime interesante edhe për vendin e origjinës së Onufrit në Shqipëri: Përkundrazi, duke menduar për Beratin në Shqipëri, kujtojmë se Berati asokohe ishte qyteti më i rëndësishëm, të paktën në Shqipërinë qendrore dhe seli e rëndësishme peshkopale, duke përvetësuar titullin e metropolit; mbiemri superlativ që i është

dhënë, nuk ndodh të interpretohet në sensin relativ si "qyteti më i shkëlqyer i botës", por në sensin absolut si "më i shkëlqyeri" (λαμπροτάτης πόλεως), i cili të kujton emrin Pulcheriopolis dhe emrin e mëvonshëm Beligrad (qyteti i bardhë). Të dy leximet, të Christides dhe Orlandos, kanë të përbashkët rrokjen BE, e përbashkët edhe me Berat. Leximi i Christides mund të jepet:

*ΓΡΕΒΕΝΙΟΝ për ΒΕΡΑΤΙΟΝ, leximi i Orlandos: ΒΕΝΕΤΙΟΝ për ΒΕΡΑΤΙΟΝ*

*Data, e cila paraprin vetëm 7 vjet përpara asaj të parës tashmë të shënuar, të veprimtarisë së piktorëve, pranon një identifikim që mund të jetë i mbështetur fuqimisht nga shqyrtimi i veprave të Kastorias dhe të Shqipërisë, në përputhje të plotë nga ana stilistike. Për këtë mund t'i jepet merita e duhur Th. Popas, i cili në analizat e veprave të Shqipërisë ka nxjerrë në dritë karakteristikat.*

*Prandaj besojmë se duhet të plotësojmë dhe të korrigojmë të dhënat që ai ka dhënë sipas mënyrës së mëposhtme: Onufri, piktorprift, ishte nga Berati ose të paktën jetoj aty sa të linte gjurmët e veprimtarisë së tij artistike, si dhe një bir trashëgimtar të artit të tij, i njohur aty si "biri i Onufrit". Veprimtaria e tij e shquar fillon, për ne, me veprat e datuara nga Apostolioni i Kastorias, 1547; ishte edhe protopapas i Elbasanit, por gjithmonë nën juridiksionin e Beratit dhe kësajoi i lindur në Berat apo në Elbasan, megjithatë munda ta kalojë këtë post në një vend pak larg, si beratas. [6]*

Është fat i madh për kulturën shqiptare që At Valentini i përdori njohuritë e tij të mëdha ikonografike, historike, bizantologjike në përgjithësi,

teologjike për të studiuar piktorin më të madh shqiptar të Mesjetës, Onufrin. Duke lexuar rreshtat e mësipërme të At Valentinit mbi Onufrin, të vjen keq që ai nuk u mor edhe më tepër me këtë piktor të madh, se kështu do të na kishte lënë një studim shterues mbi veprën e tij. Por, ndoshta përsëri do të na vinte keq, se kështu At Valentini do të kishte lënë pas dore studime të tjera albanologjike me të cilat u mor në vitet në vijim.

## REFERENCAT

- Shiko "Piktori Shqiptar i shekullit XVI, Onufri nga Neokastra-Elbasan", në "Buletin për Shkencat Shoqërore, Tiranë 1953, Nr. III". TH. POPA – Onufri, Piktori i madh shqiptar i shekullit XVI, ib., 1957. I. ID. – Piktorët mesjetarë shqiptarë – Tiranë, 1961 – f. 37-62. 298 NDRICIM KULLA ID. – Onufri ikonograf i madh shqiptar – në "Buletin", 1962, I. ID. – Piktor Onufri dhe gjendja e artit piktural në vendin tonë gjatë shekujve të mesjetës, në "Buletin", 1962, IV.
- Zef Valentini: "Saktësime rreth piktorit shqiptar gjysmëbizantin, Onufri", "Shejzat", 1962, nr. 5-6, f. 183.
- ΟΡΛΑΝΔΟΣ – Τὰ βυζαντινά μνημεία τῆς χαστορίας – në "Αρχεῖον" IV (1938) dhe nga PELEKANIDES (ΠΕΛΕΚΑΝΙΔΗΣ – χαστρια – Selanik 1953, tab. 189-203.
- Zef Valentini: "Saktësime rreth piktorit shqiptar gjysmëbizantin, Onufri", "Shejzat", 1962, nr. 5-6, f. 183.
- Zef Valentini: "Saktësime rreth piktorit shqiptar gjysmëbizantin, Onufri", "Shejzat", 1962, nr. 6, f. 183/.
- Zef Valentini: "Saktësime rreth piktorit shqiptar gjysmëbizantin, Onufri", "Shejzat", 1962, nr. 6, f. 183.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Hyseni: Mbi nëntë mijë ulëse do të ketë stadiumi i Gjilanit

**GJILAN, 11 SHKURT** - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka prezantuar të dielën projektin e stadiumit të qytetit. Hyseni ka bërë të

ditur se kostoja e këtij projekti është 15 milionë euro, teksa do të ketë mbi nëntë mijë ulëse. "Tashmë janë trajtuar dy ankesa dhe

presim përgjigjen e OSHP për të vazhduar me shpalljen e fituesit dhe fillimin e punimeve. Pas shumë sfidave, stadiumi po

jetësohet! Projekt final e zbatues, buxheti i siguar, mbi 9000 ulëse, kategoria IV, stadium modern", ka thënë Hyseni.



## Llapi mposhti në derbi Dritën, fitojnë Ballkani dhe Prishtina

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 11 SHKURT** - Skuadra kampione në fuqi dhe lidere aktuale e Superligës, Ballkani e ka nisur sezonin pranveror me fitore, pasi të dielën në Prizren e mposhti Lirinë (0-3). Në minutën e 21-të, Gentril Halili e shënoi golin e parë në ndeshje, derisa për golin e dytë është përkujdesur Almir Kryeziu, në minutën e 59-të. Golin e tretë dhe të fundit në ndeshje e shënoi Armend Thaqi. Pas kësaj fitore, Ballkani që është në vendin e parë ka 43 pikë, kurse Liria vazhdon të jetë në pozitën e fundit me vetëm 9 pikë. Të dielën fitore ka shënuar edhe skuadra e Prishtinës, e cila në Lipjan e mposhti Feronikelin 74 me rezultat 2-0. Sulmuesi Jalen Blesa e kaloi skuadrën kryeqytetase në epërsi në minutën e 22-të. Ndërsa për rezultatin 2-0 është

përkujdesur Mërgim Pefçeli (58'). Prishtina është e katërta në tabelë me 29 pikë, kurse "Nikli" është në vendin e shtatë me 21 pikë. Ndeshja e tretë që u zhvillua të dielën ishte ajo në mes Dukagjinit dhe Malishevës, derisa vendasit nga Klina dolën fitues me rezultat 2-1. Ishin mysafirët që kaluan të parët në epërsi me golin e shënuar nga Drilon Hazrollaj në fund të pjesës së parë, kurse vendasit në pjesën e dytë shënuan dy gola me anë të Iljasa Zulfiut dhe Paulo Silvës për të rrëmbyer pikët e plota. Malisheva është në vendin e



pestë me 29 pikë, kurse Dukagjini është një pozitë më poshtë me dy

pikë më pak. Të shtunën janë zhvilluar dy ndeshje tjera të kësaj xhiro, kurse Llapi ka shënuar fitore kundër Dritës në Gjilan, me rezultat 1-0. Golin e fitores për Llapin e realizoi Arbnor Ramadani, në minutën e 31-të pas asistimit të Diar Vokrrit. Ndërkaq, skuadra e parafundit në renditje, Fushë Kosova e ka nisur stinorin pranveror me barazim ndaj Gjilanit, në ndeshjen e zhvilluar

T° m°rkur°n shorti p°r erekfinalen e Kup°s n° futboll

Komisioni i Garave i ka njoftuar klubet pjesëmarrëse të çerekfinalëve të Kupës së Kosovës se shorti për këtë fazë të garave do të tërhiqet, të mërkurën (më 14 shkurt), në orën 12:00, në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK). Pjesë e shortit do të jenë të të skuadra: Prishtina, Malisheva, Suhareka 23, Vjosa, Ballkani, Drita, Dukagjini dhe Trepça'89.

### SUPERLIGA - Java 19

Prishtina - Feronikeli	2-0
Liria - Ballkani	0-3
Dukagjini - Malisheva	2-1
Drita - Llapi	0-1
Fushë-Kosova - Gjilani	1-1

### Tabela

	Pikë
1. Ballkani	43
2. Llapi	37
3. Drita	34
4. Prishtina	29
5. Malisheva	29
6. Dukagjini	27
7. Feronikeli 74	21
8. Gjilani	19
9. Fushë Kosova	11
10. Liria	9

në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan, me rezultat 1-1. Sulmuesi Senad Jarović kaloi në epërsi Gjilanin pesë minuta pa u mbyllur pjesa e parë, derisa një pikë për Fushë Kosovën e siguroi Dorent Hajdari, në minutën e 76-të.

## Prishtinasit fitojnë në Gjakovë, Trepça regjistron fitoren e 14-të radhazi

**GJAKOVË, 11 SHKURT** - Para Final 8 Kupës së Kosovës, Sigal Prishtina ka shënuar fitore ndaj Vëllaznimit në Gjakovë me rezultat 64:71 (23:15, 19:22, 9:17, 13:17), në javën e 21-të të Prince Caffè Superligës. Pas një fillimi të barabartë, kuqezinjët shkëputen në 19:11, derisa çerekun e parë e fitojnë 23:15. Bardhekaltrit rikthehen në periudhën e dytë për të ngushtuar shifrat, ku pjesa e parë përfundon 42:37. Perioda e tretë ishte vendimtare, pasi



prishtinasit ishin më të mirë për të përmbysur shifrat dhe me lojë të mirë vazhduan edhe në dhjetë minutat e fundit për të fituar 64:71. Te vendasit u dalluan Myreon Jones dhe Jahenns Manigat me nga 18 pikë, derisa te mysafirët më të mirët ishin Dardan Berisha me 18 pikë dhe Donte Clark me 16 pikë e tetë kërcime. Vëllaznimi mbetet i pesti me nëntë fitore e 12 humbje, kurse Sigal Prishtina e treta me 14 fitore e shtatë humbje. Ndërsa Proton

Cable Prizreni shënoi fitore ndaj Istogut me rezultat 87:79 (19:14, 30:15, 20:27, 18:23). Te prizrenasit u dalluan Ty Cockfield me 18 pikë e tetë kërcime dhe Arti Hajdari me 20 pikë, kurse te istogasit u dalluan Tyres Prince me 23 pikë e gjashtë kërcime dhe Desmond Holloway me 18 pikë e gjashtë kërcime. Proton Cable Prizreni numëron gjashtë fitore e 15 humbje, kurse Istogu një fitore e 20 humbje. Trepça ka vazhduar me fitore, edhe pse

nuk ishte aspak e lehtë përballë Golden Eagle Yllit 78:73 (17:26, 18:17, 23:13, 20:17). Më i miri te Trepça ishte Jordy Tshimanga me 18 pikë e 19 kërcime, duke u ndihmuar nga Drilon Hajrizi me 18 pikë dhe Darnell Edge me 16, derisa te mysafirët u dalluan Nate Grimes me 18 pikë e tetë kërcime dhe Alonzo Verge Jr me 20 pikë. Trepça është e para me 19 fitore e dy humbje, kurse Golden Eagle Ylli i katërti me 12 fitore e nëntë humbje.

## Muriqi në minutat e fundit i sjell fitoren Mallorcas

**MALLORCA, 11 SHKURT** - Vedat Muriqi është kthyer pas tre muajsh si startues te Mallorca në ndeshjen ndaj Rayo Vallecanos, ku arriti të shënojë golin e fitores. Sulmuesi "dardan" kishte marr një lëndim në ndeshjen e Kosovës ndaj Izraelit ku fituam 1-0 dhe që atëherë ishte duke u rikuperuar. Ai

luante herë pas here nga banka rezervë, por sot ishte startues dhe këtë gjë ia shpërbleu trajnerit. Rezultati ishte 1-1 me golat e Antonio Sanchez (Mallorca) dhe Alvaro Garcia (Rayo Vallecano), kur ndeshja po shkonte në minutat e fundit. Në minutën e parë të kohës shtesë, doli në skenë lojtari kryesor i

Mallorcas, Vedat Muriqi, i cili shënoi për 2-1, e që doli të jetë goli i fitores. Për këtë paraqitje Muriqi nga SofaScore u vlerësua me notën 7.7, si lojtari më i mirë i ndeshjes. Ai kishte tri goditje në portë dhe fitoi dhjetë duele. Ky ishte goli i pestë këtë sezon për Muriqin në La Liga, ku ka edhe dy asistime.





Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë, shpall këtë:

## KONKURS

**Titulli i pozitës:** Kryepunëtor për bartjen e mbeturinave –Njësia në FushëKosovë –1 pozitë

**Institucioni:** Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A –Prishtinë

**Titulli i Mbikëqyrësit/Raporton tek:** Menaxheri i Njësies dhe Drejtori Operativ

**Orari i Punës:** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e emërimit:** me afat të pacaktuar

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Organizon, kontrollon dhe përcjellë punën e punëtorëve në zonën në të cilën është i caktuar;
- Bën caktimin e punëtorëve dhe numrin e automjeteve në kryerjen e punëve në Operativë;
- Mban evidencën ditore mbi prezencën e punëtorëve në punë si dhe ditarin e punës mbi ecurinë e procesit të punës;
- Kontrollon kualitetin e kryerjes së shërbimeve, shfrytëzimin e mjeteve në punë, evidenton dhe realizon prioritetet e detyrave të përditshme dhe të rastit;
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit;

**Shkathtësitë e kërkuara:** (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi bashkëpunimi, ndërpersonale si dhe pune në grup;

**Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës:** (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale;

**Konkursi është publikuar më datë 12 shkurt 2024 dhe mbyllet më datë 26 shkurt 2024.**

**APLIKACIONI:** Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

1. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës (*Vërtetimi ose kontrata e punës*);
3. Dokumentin e identifikimit–letërnjoftimi i fotokopjuar;
4. Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

### **MËNYRA E APLIKIMIT:**

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në pliko (zarfë) të mbyllur në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

### **KUSHTET E PJESEMARRJES NË KONKURS:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

### **VËREJTJE:**

**APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRINË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.

Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Prema članu 8. Zakona br. 03/L-212 rada, član 4 Upravnog uputstva br.07/2017 o regulisanju postupka konkurencije u javnom sektoru, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A kurano izjavljuje:

## KONKURS

**Naslov položaja:** Glavni radnik za otpad - Jedinica u Kosovu FušeKosovo – 1 pozicija

**Institucija:** Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A – Priština

**Nadzorni naslov: /Izveštaji za:** Upravnik Rukovodilac jedinice i operativni direktor

**Radno vreme:** 40 sati nedeljno

**Trajanje zakazane obaveze:** neodređeno vreme

**Dužnosti i odgovornosti :** (kratak opis glavnih zadataka)

- Organizujte, kontrolišite i pratite rad radnika u oblasti u kojoj je dodeljen;
- Dodeljuje zaposlenima i broj vozila u izvođenju poslovanja;
- Svakodnevno čuva dokaze o prisustvu radnika na poslu i radnom dnevniku o učinku procesa rada;
- Kontroliše kvalitet pružanja usluga, korišćenje alata na poslu, identifikuje i ispunjava prioritete svakodnevnih i povremenih zadataka;
- A ostale stvari se rade po komandi vođe.

**Potrebne su veštine:** (potrebne veštine i veštine za ovaj posao)

- Veštine komunikacije i planiranja rada;
- Saradničke, međuljudske veštine i timski rad;

**Kvalifikacije za obrazovno, profesionalno i radno iskustvo:** (kvalifikacije i iskustvo potrebno za ovaj posao)

- Diploma srednje škole;
- Najmanje jedna (1) godina profesionalnog iskustva;

**Konkurs je objavljen 12 februara 2024 godine, a zatvoren je 26 februara 2024 godine.**

**Prijava:** Prijava mora da sadrži potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

1. Dokaz o školskim kvalifikacijama;
2. Dokaz o radnom iskustvu (*dokaz o zaposlenju ili ugovoru*);
3. Identifikacioni dokument–fotokopiranu identifikacionu karticu;
4. Potvrde od suda da niste pod istragom.

### **REŽIM APLIKACIJE:**

Prijavni formular se uzima i podnosi u zatvorenoj koverti u arhivi KRM "Pastrimi" SH.A, "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština.

Prijava poštom: Prijava kompletna sa dokumentima može se podneti i poštom na adresu: "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština, 10000. Prijave poslate putem pošte treba da zadrže žig na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate putem pošte, koje nose poštansku marku na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu posle ovog roka i nekomplikovane uopšte neće biti razmatrane.

### **USLOVI UČEŠĆA NA KONKURSU:**

Pravo na primenu imaju svi građani Republike Kosovo starosne dobi većine koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu pripremu i stručnu sposobnost obavljanja zadataka i koji poseduju fizičke veštine potrebne za obavljanje odgovarajućeg položaja.

KRM "Pastrimi" AD nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica na Kosovu.

### **UPOZORENJE:**

**PRIJAVE I NEKOMPATIBILNA DOKUMENTACIJA PREMA ZAHTEVIMA NAVEDENIM NA OVOM KONKURSU I ONIMA KOJI STIGNU PO ISTEKU ROKA KONKURSA NEĆE BITI RAZMATRANI.**

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Za više informacija možete nas kontaktirati na br. Тел: +383 (0) 38 603 191

**MEKA**  
®  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

